**VENDIM**
**Nr. 114, datë 10.6.2024**

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR KËRKESËN E SHOQËRISË "FU-GEN" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", 38, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; nenit 14, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.6.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 886/14 prot., datë 7.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi licencimin e shoqërisë 'FU-GEN' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "FU-GEN" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 886 prot., datë 4.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 62, datë 12.4.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencim e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 886/3 prot., datë 22.4.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe i ka evidentuar informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet ende në aplikimin e saj.

- Gjithashtu me shkresën nr. 1030 prot., datë 2.5.2024, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.

- Shoqëria me shkresën nr. 886/4 prot., datë 2.5.2024 ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 93, datë 13.5.2024, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me aplikimin e shoqërisë "FU-GEN" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme apo dhe planifikimin e një seance dëgjimore për të sqaruar dokumentacionin që ka mbetur ende për t'u plotësuar dhe depozitimin e tij në vijim në ERE.

- Me shkresën nr. 886/6 prot., datë 22.5.2023 dhe e-mail-in njoftues protokolluar më pas në ERE me nr. 886/9 prot., datë 4.6.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar zhvillimin e një seance dëgjimore, për plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të plotësuar pjesërisht prej saj.

- Shoqëria nuk u paraqit në seancën dëgjimore, por ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 886/7 prot., datë 27.5.2024 dhe nr. 886/8 prot., datë 29.5.2024, nr. 886/11 prot., 886/12 prot., datë 6.6.2024 dhe nr. 886/13 prot., datë 7.6.2024.

- Në këto kushte dhe në mbështetje të përcaktimeve të nenit 14, pika 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, dhe nenit 67 të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së

Shqipërisë", vlerësohet zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "FU-GEN" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim vlerësimin/ sqarimin e dokumentacionit të depozituar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërisë "FU-GEN" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "FU-GEN" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**